



VENDIM RRETH ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Data e miratimit: 23 nëntor 2011

Numri i lëndës 2010-01

Z. Djeljalj Kazagic

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT MË 8 PRILL 2011

1. Më 8 prill 2011 Paneli ka marrë vendimin e paraqitur në vijim lidhur me ankesën e parashtruar nga z. Djeljalj Kazagic më 2 shtator 2010:

Paneli me shumicë votash,

Shpall ankesat të pranueshme lidhur me procedurat civile në Gjykatën Komunale të Mitrovicës dhe procedurat penale pranë prokurorit të EULEX-it,

Konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1 të kësaj Konvente,

Shpall të përshtatshme se nga pikëpamja e gjetjeve të fakteve të paraqitura më lart dhe nga pikëpamja e ligjit, të bëhen rekomandime tek ShM, dhe

REKOMANDON VEPRIMET KORRIGJUESE NË VIJIM:

ShM duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për largimin e gjendjes së pasigurisë që është duke ndikuar në gëzimin e qetë të pronës nga parashtruesi i ankesës, në veçanti duke vepruar si në vijim,

- të shqyrtoj a ishin plotësuar kushtet që rasti civil të merrej përsipër nga gjykatësit e EULEX-it, siç përcaktohet në Nenin 5 paragrafi 1 (c) (ii) ose (iii) i Ligjit për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë;

- të jep arsyet për çka duket se nuk ka pasur përparim në hetimin që ishte hapur nga prokurori i EULEX-it, si pasojë e kërkesës së parashtruesit të ankesës së datës 25 qershor 2009;

- për më tepër, të shqyrtoj në rrethanat e rastit të parashtruesit të ankesës, se a ishin plotësuar kushtet e nevojshme që kompetenca dytësore e prokurorit të EULEX-it të zbatohet; dhe

- të shqyrtohet se çfarë hapa mund të ndërmerren me ndihmën ose përfshirjen e EULEX-it në mënyrë që të sigurohet zbatimi përfundimtar i vendimit gjyqësor i datës 11 dhjetor 2007.

ShM ftohet të njoftoj Panelin dhe parashtruesin e ankesës rreth masave që janë ndërmarrë, dhe rreth të rezultateve që kanë dalë prej tyre, jo më vonë se data 31 tetor 2011.

II. INFORMATA NGA ShM I EULEX-it

2. Më 7 qershor 2011 ShM ka njoftuar Panelin se gjetjet janë duke u studiuar dhe rekomandimet janë duke u analizuar.

3. Përmes një letre të datës 26 tetor 2011, ShM ka njoftuar Panelin si në vijim:

- EULEX-i ka gjetur dosjet e rastit në fjalë në Gjykatën Komunale të Mitrovicës dhe ka caktuar një gjykatës për të kryer një analizë në mënyrë që të përcaktohet se a ishin plotësuar kushtet që rasti i parashtruesit të ankesës të merrej përsipër nga gjykatësit e EULEX-it. Pas një shqyrtimi të paanshëm të materialeve në dispozicion, ishte vendosur nga ky gjykatës i caktuar se kushtet ishin të plotësuara.

- EULEX-i nuk kishte hapur ndonjë hetim të prokurorisë për rastin në fjalë, pasi ajo veç se ishte hetuar nga prokurori

vendor para se parashtruesi i ankesës të parashtronte ankesën në EULEX.

- Edhe pse EULEX-i ka autoritet ligjor që të merr përsipër ndjekjen penale të rastit në fjalë, kryeprokurori i EULEX-it pasi kishte kontrolluar me vëmendje dosjen e lëndës, kishte vendosur që mos ta merrte përsipër lëndën.
- Pavarësisht nga ky shqyrtim i vëmendshëm dhe i hollësishëm i kryer nga gjykatësit e prokurorët e EULEX-it dhe nga udhëheqësit më të lartë të Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it, ishte konstatuar se dhënia e përparësisë rastit në fjalë nuk do të çonte përpara synimet e EULEX-it, e as nuk do të përmirësonte gjendjen e përgjithshme në sistemin gjyqësor të Kosovës. Prandaj, shqyrtimi i këtij rasti nuk kishte përparësi ndaj rasteve të tjera që ishin në pritje pranë gjykatave.

4. Përpos kësaj, ShM deklaroi se e kupton dhe i vjen keq për gjendjen e parashtruesit të ankesës, dhe se ai është në dijeni rreth numrit të madh të lëndëve gjyqësore që nuk janë kryer brenda sistemit gjyqësor në Kosovë.

III. INFORMATA NGA Z. DJELJALJ

5. Më 3 nëntor 2011, z. Kazagic ka njoftuar Panelin se nuk ishte shënuar ndonjë përparim sa i përket rastit të tij në Mitrovicë. Prona e tij ende është e regjistruar si hipotekë për një kredi që ishte marrë nga një person, i cili nuk është pronar i pronës. Parashtruesi i ankesës nuk ka qenë në gjendje që të korrigjoj të dhënat e regjistruara në Agjencisë Kadastrale.
6. Sidoqoftë, është raportuar se ka pasur një përparim sa i përket rastit që ka qenë në pritje pranë njësisë për hetimin e krimeve ekonomike në Prishtinë që prej datës 30 qershor 2008. Vëllai i parashtruesit të ankesës, i cili është bashkëpronar i pronë në fjalë, ishte ftuar të paraqitej në stacionin policor nr. 2 në Prishtinë më 6 dhjetor 2011 për të ofruar dëshmi për hetimin e rastit.

IV. VLERËSIM NGA PANELI

7. Paneli mori parasysh informatat e pranuar nga palët.
8. Paneli është në dijeni rreth numrit të madh të lëndëve të papërfunduara pranë Gjykatës Komunale të Mitrovicës dhe problemeve të vazhdueshme të cilat përballet kjo gjykatë në kontekst të gjendjes politike në rajon.
9. Megjithatë, është për të ardhur keq se si lënda e parashtruesit të ankesës nuk është proceduar që prej atëherë kur ai kishte

parashtruar ankesën tek Paneli. Paneli konstaton se EULEX-i i ka ndërmarrë disa masa për t'iu qasur gjendjes së parashtruesit të ankesës brenda kornizës së mandatit ekzekutiv.

10. Sa i përket zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Paneli, pas shqyrtimit të informatave të ofruara nga palët,

PANELI NJËZËRI

Konstaton se lidhur me këtë rast, ShM i ka ushtruar funksionet siç duhet dhe,

Vendos ta mbyll hetimin e këtij rasti.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit